



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT “ERMIR GODAJ”

Adresa: Rr. Abdi Toptani, Qendra Torre Drin, kati 2, Nr. 33, Tirane.

Cel. 0684054605, 0682099471, email: ermirgodaj@mail.com

Nr. 1062 /Prot.

Tirane, me 03 / 03 / 2022

SHPALLJE

Une Ermir GODAJ permbarues gjyqesor privat, i pajisur me Çertifikate Nr. 82 Maj 2012 dhe me Nipt L217160221, pasi studiova materialet e dosjes permbarimore Nr. 480/Rregj., bazuar ne Urdherin e Ekzekutimit Nr. 11-2013-505(124) date 30.01.2013 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Durrës.

KONSTATOVA:

Se eshte depozituar prane permbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj kerkesa e kreditores Alba Ziu, trashegimtare ligjore e te ndjerit Kozma Ziu sipas Vendimit per leshimin e deshmise se trashegimise ligjore Nr. 10311 date 27.11.2008 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, se bashku me “Urdherin e Ekzekutimit” te leshuar per Titullin Ekzekutiv (Vendim Civil) Nr. 2695 datë 16.10.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me pale dhe objekt:

Kreditore: Alba Cane (Ziu)
Debitor: Abdulla Shamku
Objekt: Regjistrim Vendimi

Pas paraqitjes nga pala kreditore te kerkeses per ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv te sipercituar, nga permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj ne mbeshtetje te nenit 517,518 e vijues te K.Pr.Civile dhe neneve 192,193 te Kodit Civil jane kryer procedurat permbarimore, duke urdheruar me shkresen Nr. 361/Prot date 27.01.2014 Zyren Vendore te Rregjistrimit Pasurive te Paluajtshme Tirane te rregjistroje ne rregjistrat e pasurive te paluajtshme vendimin gjyqesor.

Pas kryerjes se nje sere veprimesh permbarimore per te cilat eshte vene ne dijeni rregullisht pala kreditore Alba Cane (Ziu), me date 30.06.2016 eshte kerkuar prej saj qe te mos kryhet asnje veprim i metejshem permbarimor deri ne njoftim te dyte, veprime keto te pasqyruara ne proces-verbalin e veprimeve permbarimore te dates 30.06.2016.

Ne vijim pala kreditore Alba Cane (Ziu) me shkresen e dates 13.01.2022 ka kerkuar heqjen dore nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv te sipercituar.

E ne keto kushte bazuar ne nenin 616/b te K.Pr.Civile ku thuhet se : “Ekzekutimi pushon kur kreditori heq dore me shkrese nga ekzekutimi”, me Vendimin Nr. 97/Prot. date 13.01.2022 eshte pushuar ekzekutimit te Urdherit te Ekzekutimit Nr. 11-2013-505(124) date 30.01.2013 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Durrës, te leshuar per Titullin Ekzekutiv (Vendim Civil) Nr. 2695 datë 16.10.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, per shkak se pala kreditore ka hequr dore nga ekzekutimi i vendimit.

Vendimi Nr. 97/Prot. date 13.01.2022 i eshte derguar pales debitore Abdulla Shamku. Nga konfirmimi i ardhur nga sherbimi postar, nga deftesa e komunikimit rezulton se **debitori Abdulla Selami Shamku, i vtl.1951**, njoftuar ne adresen :

- Lagjia 13, Plazh, shtepi private prane ish-frigoriferit, eshte "I panjohur".

Sa me siper, konform nenit 133 te K.Pr.Civile, vendimi i pushimit duhet bere me shpallje.

Nje kopje e kesaj shpallje te vendoset ne Zyren e Permbaruesit Gjyqesor Ermir Godaj, nje tjeter ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Durres, nje kopje ne Bashkine Durres, nje kopje ne Njesine Administrative – Rajoni Nr.5, nje kopje ne adresen e banimit te debitorit Lagjia 13, Plazh, shtepi private prane ish-frigoriferit, nje kopje ne dosjen permbarimore dhe nje kopje do te publikohet ne website e zyres <http://zyrapermbarimit.com/>.

Me kete shpallje njoftimi i shkreses "Vendim per pushimin e Urdherit te Ekzekutimit, me kerkese te pales kreditore" Nr. 97/Prot. date 13.01.2022 te permbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj quhet i kryer konform nenit 133 te K.Pr.Civile.

PERMBARUESI GJYQESOR

Ermir GODAJ

